

VENDIM
Nr.83, datë 24.12.2007

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË KËRKESËS SË KESH SHA PËR
DISA NDRYSHIME NË “RREGULLAT DHE PROCEDURAT E SHKËMBIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të nenit 2 të ligjit nr.9626, datë 16.10.2006 “Për disa shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike””, të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s” neni 18 dhe të “Rregullave dhe procedurave të shkëmbimit të energjisë elektrike”, neni 12, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.100, datë 27.12.2006, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 24.12.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e KESH sh.a. për disa ndryshime në “Rregullat dhe procedurat e shkëmbimit të energjisë elektrike”,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së KESH sh.a. për disa ndryshime në “Rregullat dhe procedurat e shkëmbimit të energjisë elektrike”,

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta